



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E EKONOMISE  
*Drejtoria e Administrimit te Prones Publike*

URDHER

Nr. 286 Date 25.8.2004

PER

**ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.A. "UJESJELLESII FSHAT" SHKODER**


Drejtuar : Sh.A. "UJESJELLESII FSHAT" SHKODER

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, Ligjit Nr. 8885 date 22.04.2002 dhe neni 128, 150 te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare, me cilesine e aksionerit te vetem ,

**URDHEROJ:**

1. Kapitali Themeltar te zvogelohet per vleren 121 300 000 leke, e barabarte me 121 300 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion, qe i perkasin vleres se sistemeve qe do te kalojne ne Komunen Bushat dhe Postribe.
2. Kapitali Themeltar i Sh.A. "Ujesjellesi Fshat" Shkoder, **behet 410 600 000 leke** i barabarte me 410 600 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion. Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.



**R A P O R T**  
**I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR**  
**PER**  
**ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.A.“UJESJELLES” FSHAT SHKODER**

MINISTRISE SE EKONOMISE  
TIRANE

Zoterinj,


Ne zbatim te Urdherit Nr.219 date 30.06.2004 te Ministrit te Ekonomise paraqesim raportin qe kemi pergatitur per zvogelimin e kapitalit te SH.A. “Ujesjellesi” Fshat Shkoder si rrjedhoje e kalimit te pasurise se paluajtshme komunave Bushat dhe Postribes.

Per kete qellim kemi ndjekur ne proces duke dhene konsulencen e nevojshme, punen per kalimin e pasurise konforme VKM Nr.173 date 26.03.2004 “Per transferimin e pronave te paluajtshme shteterore te sisitemit te ujesjelles – kanalizimeve ne pronesi te njesive te qeverisjes vendore” dhe te udhezimeve dikasteriale te dala ne zbatim te tij.

Komisionet dypalshe, duke funksionuar sipas udhezimeve te dhena nga Ministrite perkatese, kane perpiluar dokumentacionin ligjor te kalimit te pasurise dhe mbi kete baze jane dorezuar ndertesat, tubacionet dhe instalimet teknike me makinerite e paisjet perkatese te ujesjellesit nga SH.A. “Ujesjellesi” Shkoder ne Komunen e Bushatit dhe ne Komunen e Postribes. Rezerva jone ka te beje me mungesen e rregjistrimit ne hipoteke te pasurive te paluajtshme qe i nenshtrohen ketij kalimi.

Verifikuam inventaret dhe aktet perkatese te dorzimit te sistemeve te ujesjellesave qe kaluan ne pronesi te Komunave Bushat dhe Shkoder dhe krijuam bindjen tone se vleresimi i tyre eshte bere sipas kosos historike te rivlersuar me rastin e transformimit te ish Ndermarrjes “Ujesjellesi” Shkoder ne shoqeri tregtare. Vlefte fillestare e aktiveve qe transferohen eshte e njejte me ate te paraqitur ne bilancin e Shoqerise me daten 31.12.2003, bilanc i cili eshte eshte Audituar dhe certifikuar nga Eksperti Kontabel i Autorizuar sipas ligjit 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite Tregtare”. Ndersa amortizimit te llogaritur dhe te deklaruar ne Bilancin date 31.12.2003 per keto aktive i u shtua edhe ai qe i perket periudhes Janar-Qershor 2004, duke zbatuar te njejtat norma te aplikuar edhe ne vitin e kaluar.

Ne menyre te permbledhur, vlefte e aktiveve qe u kaluan nga SHA “Ujesjellesi” Shkoder ne komunat Bushat dhe Postribes, e llogaritur sipas akteve te inventarizimeve analitike perkatese, eshte si me poshte vijon :



I.-Aktive qe kalojne nga SH.A."Ujesjellesi" Shkoder ne pronesi  
te **Komunes Bushat**

	<u>Ne leke</u>		
	<u>Vlefte fillestare</u>	<u>Amortizimi</u>	<u>Vlefte neto</u>
1. Ndertesa.....	51.865.699.	10.870.346	40.995.353
2. Tubacione.....	73.750.629	24.075.923	49.674.706
3. Makineri e paisje te instaluara.....	<u>6.559.680</u>	<u>978.174</u>	<u>5.581.506</u>
Gjithesej,,,,,,,,,,,,,	132.176.008	35.924.443	96.251.565

II.-Aktive qe kalojne nga SH.A."Ujesjellesi"Shkoder ne pronesi  
te **Komunes Postribe**

	<u>Ne leke</u>		
	<u>Vlefte fillestare</u>	<u>Amortizimi</u>	<u>Vlefte neto</u>
1. Ndertesa.....	14.367.309	1.320.543	13.046.766
2. Tubacione.....	9.788.654	1.081.284	8.707.370
3. Makineri e paisje te instaluara.....	<u>3.665.642</u>	<u>366.810</u>	<u>3.298.832</u>
Gjithesej,,,,,,,,,,,,,	27.821.605	2.768.637	25.052.968

Mbi kete baze, Sh.A. "Ujesjellesi" Shkoder pergatiti Bilancin e Ri, pas transferimit te pasurise. ( Nje kopje e tij ne 2 flete i bashkelidhet raportit). Nga verifikimi qe i beme ketij bilanci del se ne te jane pasqyruar ne menyre korrekte te gjitha veprimet kontabile te kalimit te pasurise komunave Bushat dhe Postribe, sipas VKM te lartepermendur

**OPINIONI**

Sipas opinionit tone ndryshimet e bera ne paksimin e Aktiveve te Qendrueshme per vleften neto tyre 121.304.533. leke ( Per Komunen Bushat 96.251.565 leke dhe ate Postribe 25.052.968 leke ), nga njera ane si dhe ne Kapitalin e Nenshkruar te SH.A."Ujesjellesi" Shkoder per 121.300.000 leke nga ana tjeter, jane te drejta dhe te pasqyruara ne menyre korrekte ne bilancin e riformuar te shoqerise. Diferenca prej 4.533 leke per efekte te ruajtjes se vleftes nominale te aksioneve eshte kaluar ne paksim te Diferencave nga Rivleresimi qe trashегоn shoqeria.


**PERFUNDIMI:**

Kapitali i nenshkruar i SH.A. "Ujesjellesi" Shkoder nga 531.900.000 leke, pas transferimit te pronave te paluajtshme Komunave Bushat dhe Postribe behet 410.600.000 leke

Tirane, me .28.07. 2004

Me respekt,

AHMET STOJNA




## SH.A. "UJESJELLES!" SHKODER



## B I L A N C I PAS TRANSFERIMIT TE PASURISE, DATE 30.06.2004

Gr	AKTIVI	Ref.	Gjendje pas transferimit	Gjendje me 31.12.2003
A	KAPITAL I NENSHKRUAR I PAKERKUAR			
B	AKTIVE TE QENDRUESHME		474,642,887	595,947,420
	I ) TE PA TRUPEZUARA		-	-
	II ) TE TRUPEZUARA		474,642,887	595,947,420
	a) Toka,troje, terrene,ndertime e inst.te pergjithshme		402,823,240	469,056,248
	b)Instal.teknike,makineri paisje e vegla pune		264,342,368	358,106,973
	c)Te tjera ne shfrytezim			
	e) Amortizime (-)		(192,522,721)	(231,215,801)
	h) Provizione per zhvleresim (-)			
	III ) FINANCIARE		-	-
C	AKTIVE QARKULLUESE		26,438,864	26,438,864
	I )GJENDJE TE IVENTARIT DHE NE PROCES		181,714	181,714
	a )Materiale te para dhe materiale te tjera		181,714	181,714
	b )Prodhime, punime e sherbime ne proces			
	c )Produkte dhe mallra			
	d )Te tjera gjendje iventari			
	e ) Provizione per zhvleresime (-)			
	II )KËRKESA PËR ARKETIM MBI DEBITORET		25,692,407	25,692,407
	a)Kliente per shitje e sherbime		25,692,407	25,692,407
	b)Ortake kapital i pa derdhur			
	c)Personeli dhe persona			
	d )Te tjera kerkesa			
	e ) Provizione per zhvleresime (-)			
	III)LETRA ME VLERE TE VENDOSJES PERKOHSHME		-	-
	IV ) LIKUJDETETE DHE VLERA TE TJERA ARKE		564,743	564,743
	a )Depozita ne banke dhe ne llogari te tjera		564,743	564,743
	b ) Para ne dore (arke)			
	c) Vlera te tjera arke			
	V )SHPENZIME TE PAGUARA OSE TE RREGJIST AVANCE			
D	LLOGARI TE TJERA		-	-
	TOTALI I AKTIVIT		501,081,751	622,386,284

FINANCIERI




DREJTORI

## B I L A N C I PAS TRANSFERIMIT TE PASURISE, DATE 30.06.2004

Gr	PASIVI	Ref.	Gjendje pas transferimit	Gjendje me 31.12.2003
A	<b>KAPITALET E VETA</b>		475,528,715	596,833,248
	I) KAPITALI THEMELTAR REZERVE FITIME/HUMBJE		475,528,715	596,833,248
	Nga ky l derdhur			
	a) Kapitali i nenshkruar		410,600,000	531,900,000
	b) Prime te lidhura me kapitalin			
	c) Diferenca nga rivlersimi		71,367,863	71,372,396
	d) Rezervat : -Rezerva ligjore			
	e) Fitime ose humbje te mbartuara (humbjet -)			
	f) Fitime ose humbje te ushtrimit (humbjet -)		(6,439,148)	(6,439,148)
	II ) FONDE TE TJERA TE VETAT		-	-
	III ) SUBVEZIONE PER INVESTIME			
	IV) PROVIZIONE PER RREZIQE E SHPENZIME		-	-
	a) Provizione per rreziqe			
	b) Provizione per shpenzime			
B	<b>DETYRIME</b>		25,553,036	25,553,036
	I ) TE KERKUESHME PAS ME SHUME SE NJE VITI		-	-
	II) DETYRIME TE KERKUESHME DERI NE NJE VIT		25,553,036	25,553,036
	a) Huara nga bankat dhe institutet e kreditit			
	b) Huara te tjera			
	d) Furnitore per blerje e sherbime		1,521,900	1,521,900
	e) Personeli		587,745	587,745
	h) Sigurime shogerore dhe te ngjajshme		23,361,729	23,361,729
	f) Shteti -tatime dhe taksa		81,662	81,662
	g) Ortake			
	I) Te tjera detyrime			
	III) TE ARDHURA TE MARRA OSE TE REGJIST.AVANCE			
C	<b>LLOGARI TE TJERA</b>		-	-
	<b>TOTALI I PASIVIT</b>		<b>501,081,751</b>	<b>622,386,284</b>

FINANCIERI



DREJTORI